

25341/8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr. 25341/_8_

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 19. qershor 2003, unë Majlinda Dogga, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. James Reiff në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA për depozitimin e akteve të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria anonime PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA është person juridik i së drejtës shqiptare, regjistruar me Vendimin Nr. 25341, datë 2 mars 2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me seli në adresën Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. 7/1, Tiranë dhe me aksionerë: 1) shoqërinë Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe), shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Anglisë dhe Uellsit, e themeluar më 24 Shkurt 1998 me Numër regjistri 3516266; dhe 2) shoqërinë Opportunity Transformation Investments Inc. shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Illinois, e themeluar më 19 Qershor 2000.

Më datë 30 Maj 2003 është zhvilluar mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "Partneri Shqiptar ne Mikro kredi" SHA, e cila ka vendosur:

1. Të zvogëlojë kapitalin aksioner të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA me shumën Lekë 34,080,686 (tridhjetëkatër milionë e dyqindetëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) për të mbuluar humbjet e viteve të mëparshme financiare në përputhje me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar të Shoqërisë Z. Limoz Malaj.
Me zvogëlimin e kapitalit, shuma e përgjithshme e kapitalit aksioner të shoqërisë do të jetë në shumën Lekë 412,800,920 (katërqind e dymbëdhjetë milion e tetëqind mijë e nëntëqind e njëzetë).

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- 2. Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA të datës 30 maj 2003 e cila ka miratuar zvogëlimin e kapitalit aksioner të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NE MIKROKREDI SHA me shumën Lekë 34,080,686 (tridhjetë e katër milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) për të mbuluar humbjet e viteve të mëparshme financiare në përputhje me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar të Shoqërisë Z. Limoz Malaj.

Me zvogëlimin e kapitalit, shuma e përgjithshme e kapitalit aksioner të shoqërisë do të jetë në shumën Lekë 412,800,920 (katërqind e dymbëdhjetë milion e tetëqind mijë e nëntëqind e njëzetë).

- Urdhërohet zyra e Regjistrimit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

Majlinda Dogga

